Nr._____Datë_____.___.2026

Mbi shpërndarjen e fondit financiar të mbrojtjes civile të vitit 2026 për familjet e dëmtuara nga përmbytja dhe dhënien e kompensimit financiar nga ana e Bashkisë Elbasan

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile"; VKM nr. 329 datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 datë 04.06.2026 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2026", VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028". si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile;

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e fondit financiar të kompensimit prej **7,183,980 (shtatë milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntetëqind e tetëdhtjetë)** lekë për 30 familje sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Burimet e financimit do të jetë Fondi i Mbrojtjes Civile, i parashikuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, i miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 81 datë 04.06.2026 "Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes

civile për vitin 2026" për fondin **6,241,676 lekë** si edhe fondi i Emergjencave Civile i miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028" për fondin **942,304 lekë.**

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave (Drejtoria e Mbrojtjes Civile).

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Elsid Zyma **Lutfi Lala**

Konceptoi:	Specialist	I. Hoxholli
Pranoi:	Drejtori MC	N. Sinani
Miratoi:	Dr. PPMCMBPK	Sh. Çullhaj
	Dr. Buxhet Financë	A. Merkja
	Dr. Juridike	E. Arapi
Konfirmoi:	Zv/Kryetari	K. Krasnika

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.6172 prot Elbasan me 26/02/2026

RELACION

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të hërbimeve sociale

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh." dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror", Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale nëpërmjet punonjësve të saj të Sektorit të Kujdesit të shtresave në nevojë, moshës së tretë dhe pakicave etnike, pasi shqyrtoi kërkesat dhe dokumentacionin e paraqitur për vendosje në shërbimin rezidencial për të moshuar në Shtëpinë e të moshuarve pranë Agjencisë së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Elbasan, paraqet për sistemim si më poshte:

1. I moshuari Z. Thoma Dërstila, i datëlindjes 03.07.1960, vendbanimi Derstile, Gjinar, me nr. ID G00703190T, propozohet për t'u vendosur në qendrën e përkujdesit social për të moshuar pasi është i vetmuar, i braktisur prej vitesh nga e shoqja e fëmijet. Jeton në një barake, e cila ka qenë në pronësi të vellait të tij, në kushte të mjerueshme. I moshuari nuk ka shtëpi dhe as njeri të kujdeset për të. Në këto kushte të ndodhura Z. Thoma Dërstila plotëson kriteret për t'u akomoduar në azil.

Ky vendim i dërgohet Këshillit Bashkiak për vlerësim përfundimtar, bazuar në nenin 28 të ligjit 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë.

Duke ju falenderuar !

Konceptoi: A.Coku

Pergjesese : L. Senia

Drejtor Drejtorie: M. Rexhepi

ME URDHER POROSI

ZV/ KRYETARI

Z. Renato Haxhiaj

KRYETARI

Gledian Llatja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTEVE
DREJTORIA E MBROJTJES DHE PËRFSHIRJES SOCIALE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____prot Elbasan më / /2026

P R O J E K T - V E N D I M

Nr_____/datë / /2026

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2026 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.", neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 "Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror",

V E N D O S I

Të miratojë vendosjen në Shtëpinë e të moshuarve pranë Agjencisë së Shërbimeve Sociale të Bashkise Elbasan, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

I. I moshuari Z. Thoma Dërstila, i datëlindjes 03.07.1960, vendbanimi Derstile, Gjinar, me nr. ID G00703190T.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Agjencia e Shërbimeve Sociale.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm D. Rroseni Drejtori Buxhet-Finance
Drejtori Juridik, B. Njerëzore dhe Informimit E. Arapi A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak **Kryetari i Këshillit Bashkiak**

Elsid Zyma **Lutfi Lala**

Z. Thoma Derstila, i moshuar, i vetmuar, i dalë në moshë
03.07.1960, 66 vjeç, i divorcuar.
Prej vitesh nuk ka komunikim me fëmijët e tij, të cilët jetojnë
jashtë shtetit (Greqi) me ish bashkëshorten.
Nuk ka banesë, jeton në kushte të rënduara në një banesë
që ia ka lënë, i vëllai.
Jeton në kushte të rënduara, me gjendje të reduar
shendetësore dhe social-ekonomike.
Merr pagesë aftësie të kufizuar, 12.000 lekë
Pas një aksidenti të pesuar, nuk mund të ecë dhe ka nevojë
për përkujdesje pasi nuk munden të shërbejë vetes
për nevojet bazë.

Komisioni vendosi për vendosjen e të moshuarit Z. Thoma
Derstila në qëlliin e QSB.

1. Andreana Colin
2. Manjola Rexhepi
3. Majada Balla
4. Armiola Leka
5. Geraldo Shtylla
6. Arta Voja
7. Daniela Shuli
8. Marsid Ceroni
9. Lenuta Haxhia

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Elbasan

Zyra e Gjendjes Civile 92

Datë: 02.10.2026

CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Thoma DËRSTILA	Lato	Zeliha	M	Kryefamiljar	03-07-1960	I/e divorcuar	Derstilë, Elbasan	Shqiptare	G00703190T
2.	----------									
3.	----------									
4.	----------									
5.	----------									
6.	----------									
7.	----------									
8.	----------									
9.	----------									
10.	----------									

Kjo certifikatë lëshohet për .....

Vulosur elektronikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme
Date:2026/10/02 13:21:08 +02'00'
a1996be2e3fd4e7d8e8133fdc6547822202610021321071601001

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur në një të re procedure automatike nga një sistem elektronik (Ministria e Punëve të Brendshme)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Elbasan

Njësia administrative Elbasan

Zyra e Gjendjes Civile 92

Datë: 02.10.2026

CERTIFIKATË PERSONALE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	Thoma
Mbiemri	DËRSTILA
Numri Personal	G00703190T
Emri i Babait	Lato
Emri i Nënës	Zeliha
Datëlindja	03-07-1960 (gjashtëdhjetë)
Vendlindja	Derstilë, Elbasan
Vendbanimi	Derstile; 0000; Elbasan
Gjinia	Mashkull
Gjendja Civile	I/e divorcuar
Shtetësia	Shqiptare

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vulosur elektronikisht nga Ministria e Punëve të Brendshme
Date:2026/10/02 13:20:23 +02'00'
fa4e99738a5d433e9800a02ed90883852026100213202
19901001

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Ministria e Punëve të Brendshme)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
NJESIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Nr 394 Prot

Gjinar me 02.10.2026

VËRTETIM

Vërtetojmë se **Z. Thoma Lato Dërstila** me datelindje **03.07.1960** identifikuar me nr **ID G00703190T** banor i fshatit Derstile ne Njesine Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan nuk ka prone te rregjistruar ne Njesine Administrative Gjinar.

E lëshojmë këtë vërtetim për efekt dokumenti.

Konc.
A.Qosja

Administratori i NJ.A Gjinar
Emanuel Hida

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
NJËSIA ADMINISTRATIVE GJINAR

Nr 393 **Prot** Gjinar më 02.10.2026

VËRTETIM

Vërtetojmë se **Z. Thoma Lato Dërstila** e datelindje **03.07.1960** identifikuar me nr **ID G00703190T** eshte banor i fshatit Derstile ne Njesine Administrative Gjinar, Bashkia Elbasan.

E lëshojmë këtë vërtetim me kërkesë të interesuarit për efekt dokumenti.

Konc.
A.Qosja

Administratori I NJ.A.Gjinar
Emanuel HIDA

Unë i nënshkruari THOMA LATODERSTILA,

Deklaroj se dua të shkoj në Qendrën Sociale Elbasan

për shkak se jam i paaftë edhe për faktin që për

momentin ndodhem në spital edhe mu kam kaam aaskënd të më

qëndrojë afër, unë jam i paaftë të kujdesem për veten time,

edhe mu kam kaam asnjë jam i vetëmjaftueshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR

VËRTETIM PËR PËRFITIMIN E PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Bazuar në vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë/Komisionit Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë/Komisionit Shumë-displinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Z/Znj. Thoma Dërstila me NID: G00703190T përfiton pagesë si person me aftësi të kufizuar, me periudhë vlefshmërie nga data: 01/04/2025 tek data: 01/04/2027.

Vulosur elektronikisht nga Shërbimi Social Shtetëror
Date:2026/10/02 13:32:09 +02'00'
G00703190T20261002133205960020l6

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Shërbimi Social Shtetëror)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E
SEKTORI

Nr.6084 prot. Elbasan, më 22.10.2026

RELACION

"Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Rininë 2026–2030 të Bashkisë Elbasan"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Elbasan paraqet për shqyrtim dhe miratim Planin Vendor të Veprimit për Rininë 2026–2030, një dokument strategjik që përcakton drejtimet kryesore të politikave vendore për të rinjtë gjatë pesë viteve të ardhshme.

Plani është hartuar nga Bashkia Elbasan, me asistencën e ekspertëve të UNDP-së dhe UNFPA-së, në bashkëpunim me Forumin e Qeverisjes së Hapur (OGP Local) dhe aktorë të tjerë vendorë.

Qëllimi i këtij Plani është krijimi i më shumë mundësive për zhvillimin, punësimin, mirëqenien dhe pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike, duke i konsideruar ata jo vetëm përfitues të shërbimeve, por edhe partnerë në zhvillimin e Bashkisë Elbasan.

1. Rëndësia dhe qëllimi i Planit

Të rinjtë përballen me sfida që lidhen me punësimin, zhvillimin e aftësive, pjesëmarrjen në vendimmarrje, sigurinë, mirëqenien dhe aksesin në aktivitete e shërbime.

Sipas Censusit të vitit 2023, Bashkia Elbasan kishte 21,120 të rinj të grupmoshës 15–29 vjeç. Duke marrë si bazë këto të dhëna dhe dinamikat demografike të publikuara nga INSTAT, popullsia e të rinjve për vitin 2025 vlerësohet në mënyrë orientuese në rreth 21,400 persona. Kjo kategori përbën një pjesë të rëndësishme të popullsisë dhe një potencial për zhvillimin ekonomik e shoqëror të territorit.

Plani synon të adresojë nevojat e identifikuara, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të rinjve që jetojnë në zonat rurale dhe atyre që përballen me vështirësi sociale dhe ekonomike.

Ai mbështetet edhe në përvojën e Planit Lokal të Veprimit për Rininë 2020–2023, duke siguruar vazhdimësinë e politikave vendore në këtë fushë.

2. Hartimi i Planit

Plani është përgatitur nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 385, datë 24.07.2026, me mbështetjen e iniciativës rajonale të Kombeve të Bashkuara «Të rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim», e zbatuar në Shqipëri nga UNDP dhe UNFPA.

Hartimi i dokumentit është mbështetur në analizën e të dhënave demografike dhe socio-ekonomike, shqyrtimin e dokumenteve strategjike dhe procesin e konsultimit me të rinjtë dhe aktorët vendorë.

Në këtë proces janë përfshirë mekanizmat ekzistues të pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit të Bashkisë, përfshirë Këshillin Vendor Rinor dhe Forumin e Qeverisjes së Hapur (OGP Local).

Plani është harmonizuar me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, politikat evropiane për rininë dhe dokumentet e tjera strategjike vendore, me qëllim koordinimin e ndërhyrjeve dhe përdorimin efikas të burimeve.

3. Çfarë parashikon Plani?

Plani përcakton gjashtë fusha prioritare, të cilat synojnë përmirësime konkrete në jetën e të rinjve.

Fusha prioritare	Çfarë synohet të realizohet
1. Fuqizimi ekonomik dhe punësimi i denjë	Orientim profesional, zhvillim aftësish, praktika profesionale dhe mbështetje për punësimin e sipërmarrjen.
2. Pjesëmarrja rinore dhe qytetaria aktive	Forcimi i Këshillit Vendor Rinor, dialogut me të rinjtë dhe përfshirjes së tyre në vendimmarrje.
3. Siguria dhe kohezioni social	Parandalimi i dhunës, bullizmit dhe diskriminimit, si dhe forcimi i sigurisë në komunitet dhe në mjedisin digjital.
4. Shëndeti mendor dhe mbështetja psiko-sociale	Ndërgjegjësim, informim dhe përmirësim i orientimit të të rinjve drejt shërbimeve përkatëse.
5. Arti, kultura, sporti, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	Zgjerimi i mundësive për aktivitete, vullnetarizëm, edukim mjedisor dhe përfshirje në nisma komunitare.

6. Koordinimi ndërinstitucional	Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, përmirësimi i të dhënave për të rinjtë dhe monitorimi i politikave rinore.

Për secilën fushë, Plani përcakton masa konkrete, afate zbatimi, struktura përgjegjëse, partnerë, kosto orientuese dhe tregues për matjen e rezultateve.

4. Kostot dhe burimet e financimit

Kostoja e përgjithshme vjetore orientuese e masave të Planit është 22,557,547 lekë, rreth 22.6 milionë lekë në vit.

Nga kjo shumë, 14,500,000 lekë në vit përfaqësojnë vlerën orientuese të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), të lidhur me masën 5.1. Kjo vlerë nuk përfaqëson domosdoshmërisht financim të dedikuar tërësisht për të rinjtë.

Kostot e tjera orientuese të përfshira në Plan arrijnë në 8,057,547 lekë në vit.

Kostot e Planit janë orientuese dhe janë përllogaritur në koordinim me drejtoritë dhe sektorët përkatës të Bashkisë Elbasan që zhvillojnë aktivitete dhe ofrojnë shërbime për të rinjtë. Ato mbështeten kryesisht në programet dhe fondet ekzistuese të Bashkisë, si dhe në projekte të financuara nga Bashkimi Evropian, donatorët dhe partnerët e tjerë, pa krijuar një buxhet të ri të veçantë për Planin.

5. Zbatimi dhe monitorimi

Zbatimi i Planit do të realizohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, në bashkëpunim me institucionet publike, Këshillin Vendor Rinor, institucionet arsimore, Universitetin «Aleksandër Xhuvani», organizatat e shoqërisë civile, sektorin privat dhe partnerët e tjerë.

Për të siguruar që Plani të mos mbetet vetëm një dokument strategjik, ai shoqërohet me Matricën e Planit të Veprimit dhe Matricën e Monitorimit.

Këto instrumente përcaktojnë masat që duhet të realizohen, përgjegjësitë institucionale, afatet dhe treguesit për matjen e progresit.

Parashikohet hartimi i një raporti vjetor të monitorimit, në të cilin do të pasqyrohen masat e realizuara, rezultatet e arritura, përdorimi i burimeve financiare dhe problematikat e hasura.

Informacioni mbi progresin do të publikohet për të garantuar transparencën dhe për t'u dhënë mundësi të rinjve të ndjekin zbatimin e Planit.

6. Propozimi për miratim nga Këshilli Bashkiak

Miratimi i Planit Vendor të Veprimit për Rininë 2026–2030 do t'i mundësojë Bashkisë Elbasan të ketë një dokument të përbashkët orientues për politikat rinore, me prioritete, përgjegjësi dhe mekanizma të qartë monitorimi.

Ai do të shërbejë si bazë për planifikimin vjetor të aktiviteteve, koordinimin ndërmjet institucioneve, programimin e nevojave financiare dhe mobilizimin e mbështetjes nga partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë.

Për sa më sipër, i propozohet Këshillit Bashkiak Elbasan shqyrtimi dhe miratimi i Planit Vendor të Veprimit për Rininë 2026–2030, së bashku me matricat përkatëse, sipas dokumentacionit bashkëlidhur.

Dokumentacioni bashkëlidhur:

1. Plani Vendor i Veprimit për Rininë 2026–2030, përfshirë Matricën e Veprimit dhe Aneksin I – Matrica e Monitorimit.

***Koncept**: DPBPMSP Lorena Haxhiymeri*
Pergj Dr.Int.Evr Kristina Kreka
Pergj. Sekt Rinis Sokrat Ndria
Pergj. Dr Sherb Soc Nadire Kreka
Pergj Dr. Sherb Soc Lindita Senia
***Pranoi**: Dr. Pergj Dorina Rroseni*
***Miratoi**: ZV/Kryetare Klaudia Krasnika*

KRYETARI

Gledian LLATJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr._____ Prot. **Elbasan, më____.____. 2026**

P R O J E K T V E N D I M

Nr.___, datë ___.___.2026

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR RININË 2026–2030 TË BASHKISË ELBASAN""

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe pasi shqyrtoi relacionin përkatës,

VENDOSI:

1) Miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Rininë 2026–2030 të Bashkisë Elbasan, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2) Plani përfshin Matricën e Planit të Veprimit dhe Aneksin I – Matricën e Monitorimit, të cilat përcaktojnë masat, afatet, përgjegjësitë institucionale dhe treguesit për ndjekjen e zbatimit.
3) Kostot e parashikuara në Plan kanë karakter orientues. Zbatimi i masave do të realizohet në përputhje me buxhetin e miratuar të Bashkisë Elbasan, programimin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, si dhe financimet që mund të sigurohen nga projektet dhe partnerët e zhvillimit. Miratimi i këtij Plani nuk krijon automatikisht angazhime të reja financiare.
4) Ngarkohen strukturat përgjegjëse të Bashkisë Elbasan për zbatimin e Planit, sipas fushave të përgjegjësisë dhe masave të përcaktuara në të.
5) Strukturat përgjegjëse të Bashkisë, në bashkëpunim me Këshillin Vendor Rinor dhe partnerët përkatës, të ndjekin zbatimin e Planit dhe të përgatisin raportin vjetor të monitorimit.
6) Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Konceptoi: *Pergj S.Ndria*
Pranoi: *Drejt.Pergj. D.Rroseni*
Pranoi: *Drejt Juridike E. Arapi*

Sekretari
Elsid Zyma

Kryetar
Lutfi LALA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr.609 Prot. Elbasan më 22.10.2026

RELACION

Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së Znj. Alketa Dhimitraq Koçi banues në lagjen "Kongresi i Elbasanit", nr. 1 dhe dhënien e kompensimit nga ana e Bashkisë Elbasan

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" dhe të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", sektori përkatës, pas marrjes së kërkesës nga **Znj. Alketa Dhimitraq Koçi** ka kryer konstatimin e banesës. Pas ardhjes së kërkesës në Drejtorinë e Mbrojtjes Civile me nr. 1941 prot. datë 26.8.2026, grupi i konstatimit për djegien e banesës në lagjen "Kongresi i Elbasanit", nr. 1 në datën 26.8.2026 (konfirmuar edhe nga Vërtetimi i SHMZSH nr. 10 datë 28.08.2026) ka hartuar proçes-verbalin përkatës të datës 28.08.2026. Pas plotësimit të dokumentacionit, është vijuar me përcjelljen e dokumentacionit komisionit të vlerësimit të dëmeve ngritur në Bashkinë Elbasan me Urdhër nr. 64 date 22.01.2025 "Per ngritjen e komisionit per vleresimin e demeve te shkaktuara ne objekte banimi nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi te tjera" për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga ekspertët e këtij komisioni. Ky komision, ka përgatitur preventivin mbi vlerën e dëmeve të objektit nga ana ndërtimore (sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga sistemi E-albania) duke përfshirë në të edhe vlerën e pajisjeve dhe orendive të dëmtuara (mbështetur në çmimet mesatare aktuale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ardhur me shkresë nr. 6024/1 prot. datë 22.4.2025) nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve ndërtimore të banesës së **Znj. Alketa Dhimitraq Koçi**, është në masën **146,490 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë)** lekë.
- Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi në banesës është në masën **178,825 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë) lekë.**

Në bazë të VKM-së cituar më sipër nr. 329 datë 16.05.2012 vlera e dëmeve ndërtimore në banesën e djegur, e përcaktuar nga komisioni i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë

merret nga pronari në masën prej 50% të shumës së nxjerrë.

Pra në këtë rast **146,490 x 50% = 73,245 lekë.**

Kësaj shume i shtojmë vlerën prej **178,825 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e njëzetë e pesë)** lekë që është vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi.

Në përfundim nga komisioni i vlerësimit të dëmeve shkaktuar nga djegia e banesës së **Znj. Alketa Dhimitraq Koçi** i takojnë **73,245 + 178,825 = 252,070** (dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë) lekë.

Duke Ju falenderuar,

Konceptoi:	Specialist	I. Hoxholli
Miratoi:	Drejtori MC	N. Sinani
Konfirmoi:	Dr. PPMCMBPK	Sh. Çullhaj

KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Asim Sula

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES CIVILE, MJEDISIT, BUJQËSISË, PYJEVE DHE KULLOTAVE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr.5980 Prot. Elbasan më, 13.12.2026

RELACION

Për ndryshimin e VKB Elbasan nr. 81 datë 4.6.2026
"Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2026"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 65 të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021, "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile", si dhe VKB-së nr. 154, datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026–2028", Drejtoria e Mbrojtjes Civile propozon ndryshimin e VKB-së nr. 81, me qëllim rishpërndarjen e fondit të Mbrojtjes Civile vetëm për investimet parandaluese për vitin 2026.

Pas analizimit të nevojave për ndërhyrje parandaluese dhe të situatave të evidentuara në terren, është vlerësuar e nevojshme rishikimi i përdorimit të fondeve, me qëllim orientimin e tyre drejt investimeve që kanë rëndësi për sigurinë e infrastrukturës dhe parandalimin e situatave të mundshme emergjente.

Në kuadër të zbatimit të investimeve të planifikuara për vitin 2026, nga kontratat e lidhura për objektet e mëposhtme janë krijuar teprica në objektet e prokuruara në objektet dhe vlerat e mëposhtme:

- Ndërtim i këmbëve dhe speronave të urës tip beli në fshatin Papër-Sollak, lagjja "Shehu", Njësia Administrative Papër, nga i cili rezulton një tepricë fondi prej 152,123 lekësh.
- Ndërtim i urës tip Box (3×3) në fshatin Shushicë, mbi Përroin Balta e Gaxhes, lagjja "E Vjetër", Njësia Administrative Shushicë, nga i cili rezulton një tepricë fondi prej 55,671 lekësh

Totali i tepricave është në vlerën prej **207,794 lekësh** dhe këtë fond propozojmë të përdoret për financimin e një objekti të ri me karakter parandalues.

Gjithashtu, propozohet rishpërndarja e shumës prej **230,594 lekësh** nga fondi i planifikuar për hartimin dhe shpërndarje të materialeve informuese (fletëpalosjeve), dhe shpenzimeve për transport të cilat sipas procedurave teknike financiare nuk mund të quhen investime e në këtë mënyrë nuk mund të përdoren për investimet parandaluese.

Në këtë mënyrë, krijohet një fond i përgjithshëm prej **438,388 lekësh**, i cili propozohet të përdoret për financimin e objektit "Përforcimi i këmbëve të urës mbi kolektorin kullues KK1 Shirgjan, në kryqëzimin e rrugës Kuqan–Bujqës me rrugën Bujqës–Muriqan". Ky investim është i domosdoshëm për shkak të gërryerjes së bazamentit ku mbështeten këmbët e urës, e cila rrezikon qëndrueshmërinë strukturore të saj dhe mund të çojë në shembjen e plotë të urës. Ndërhyrja synon përforcimin e strukturës mbajtëse, parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme dhe garantimin e sigurisë së urës, veçanërisht gjatë periudhave me reshje të dendura shiu, kur rritet rreziku i gërryerjes dhe cenimit të mëtejshëm të bazamentit.

Për sa i përket zërit "Hartim dhe shpërndarje të materialeve informuese", propozohet përdorimi i fondit prej 30,594 lekësh nga fondi i Emergjencave Civile i miratuar në buxhetin e Bashkisë Elbasan për vitin 2026, sipas VKB-së nr. 154, datë 24.12.2025. Ky ndryshim synon të mundësojë përdorimin e fondit për qëllimin përkatës, në përputhje me nevojat e evidentuara.

Rishpërndarja e propozuar nuk synon shtimin e fondeve përtej vlerave të përcaktuara, por përdorimin më efektiv të fondeve të miratuara dhe të kursimeve të krijuara nga kontratat e prokuruara. Në këtë mënyrë, sigurohet orientimi i burimeve financiare drejt një ndërhyrjeje konkrete parandaluese, duke ruajtur qëllimin e fondeve të Mbrojtjes Civile dhe duke rritur efektivitetin e përdorimit të tyre.

Sa më sipër, kërkojmë shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 81, nëpërmjet rishpërndarjes së fondit në vlerën totale prej 438,388 lekësh për objektin "Përforcim i këmbëve të urës mbi kolektorin kullues KK1 Shirgjan në rrugën Bujqës–Muriqan", si dhe përdorimin e fondit prej 30,594 lekësh nga buxheti i Bashkisë Elbasan për objektin "Hartim dhe shpërndarje të materialeve informuese".

Duke Ju falenderuar,

Konceptoi:	Specialist	I. Hoxholli
Miratoi:	Drejtori MC	N. Sinani
Konfirmoi:	Dr. PPMCMBPK	Sh. Çullhaj

KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARI
Asim Sula

Adresa: *Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK
Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr._____Datë _____.___.2026

Për ndryshimin e VKB Elbasan nr. 81 datë 4.6.2026

"Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të mbrojtjes civile për vitin 2026"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; nenit 65 të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM nr. 414 datë 8.7.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kritereve për përdorimin dhe shpërndarjen e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile"; VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026, si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028", si edhe pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e rishpërndarjes së fondit të Mbrojtjes Civile për investimet parandaluese për vitin 2026 prej 230,594 lekë duke shtuar edhe kursimet e kontratave të lidhura në shumën prej 207,794 lekë dhe shtimin e një objekti të ri emergjent:

PAKËSOHET

30,594 lekë Hartim dhe shpërndarje të materialeve informuese,
200,000 lekë Shpenzime për transport
152,123 lekë Ndërtim i këmbëve dhe speronave të urës tip beli në fshatin Papër Sollak (lgj. "Shehu"), Njësia Administrative Papër (tepricë nga objekti i prokuruar)
55,671 lekë Ndërtim i urës tip Box (3*3) në fshatin Shushicë mbi Përroin Balta e Gaxhes (lgj. "E Vjetër"), Njësia Administrative Shushicë (tepricë nga objekti i prokuruar)

438,388 lekë gjithsej

SHTOHET

424,713	**lekë**	Objekti "Përforcim i këmbëve të urës mbi kolektorin kullues KK1 Shirgjan në kryqëzimin e rrugës Kuqan- Bujqës me rrugën Bujqës – Muriqan"
11,891	**lekë**	Supervizim
1784	**lekë**	Kolaudim

438,388 lekë gjithsej

2. Përdorimin e fondit të Emergjencave Civile nga buxheti i Bashkisë Elbasan miratuar me VKB nr. 154 datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2026 si dhe Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar për periudhën 2026-2028", me fondin 30,594 lekë për objektin "Hartim dhe shpërndarje të materialeve informuese".
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK **KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

Elsid Zyma **Lutfi Lala**

Konceptoi:	Specialist	I. Hoxholli
Pranoi:	Drejtori MC	N. Sinani
Miratoi:	Dr. PPMCMBPK	Sh. Çullhaj
Dr. Buxhet Financë		A. Merkja
Dr. Juridike		E. Arapi
Konfirmoi:	Zv/Kryetari	K. Krasnika

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr6149 Prot Datë23.10.2026

RELACION

"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 54; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

Në vijim të kërkesave të administratorëve të rinj të Njësive Administrative Funar dhe Tregan, përkatësisht Oltian Haka, i cili ka zëvendësuar administratorin Fisnik Bozha, dhe Çelik Tashi, i cili ka zëvendësuar administratorin Mërkur Kaçi, për vënien në dispozicion të sasisë mujore prej 50 litrash karburant për realizimin e detyrave funksionale;

Komisioni për përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për mjetet motorike për vitin 2026, i ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 3, datë 06.01.2026, pas shqyrtimit të kërkesave dhe vlerësimit të karakteristikave të automjeteve të paraqitura, ka hartuar procesverbalet përkatëse dhe ka përcaktuar normativat e konsumit të karburantit për mjetet e përdorura nga administratorët, si më poshtë:

Nr.	Mjeti motorik	Administratori	Norma e konsumit të karburantit
1	Ford Fiesta, targa AA171OE	Oltian Haka	5 litra/100 km
2	Ford WAG, targa AB598LO	Çelik Tashi	5 litra/100 km

Shënim: Normativat e mësipërme përcaktohen për qëllime të përllogaritjes dhe verifikimit të konsumit të karburantit në fletët e udhëtimit, sipas përdorimit të automjeteve. Ato nuk ndryshojnë kufirin maksimal të sasisë mujore prej 50 litrash karburant për secilin administrator, të përcaktuar me vendimin e mëparshëm të Këshillit Bashkiak.
Bashkëlidhur këtij relacioni janë procesverbalet përkatëse të komisionit, të cilat dokumentojnë vlerësimin dhe përcaktimin e normativave të konsumit të karburantit për secilin automjet.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
Pranoi: P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja
Miratoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika

KRYETARI
Gledian Llatja

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Q.Stafa", Tel. +355 54 400 152, e-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web:www.elbasani.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____Prot **Datë ___.___.2026**

PROJEKTVENDIM
Nr. ____ Datë ___.___.2026

"Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 "Për miratimin e normave dhe kritereve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR."

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore'' i ndryshuar, neni 54, **", të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe** Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik„"
Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr.____datë:_____

VENDOSI :

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:.

Nr.	Mjeti motorik	Administratori	Norma e konsumit të karburantit
1	Ford Fiesta, targa AA171OE	Oltian Haka	5 litra/100 km
2	Ford WAG, targa AB598LO	Çelik Tashi	5 litra/100 km

Shënim: Normativat e mësipërme përcaktohen për qëllime të përllogaritjes dhe verifikimit të konsumit të karburantit në fletët e udhëtimit, sipas përdorimit të automjeteve. Ato nuk ndryshojnë kufirin maksimal të sasisë mujore prej 50 litrash karburant për secilin administrator, të përcaktuar me vendimin e mëparshëm të Këshillit Bashkiak.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
Pranoi: P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja
Miratoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudjo Tusha
Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

Sekretari i Këshillit Bashkiak Kryetari i Këshillit Bashkiak

ELSID ZYMA **LUTFI LALA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 05/8 Prot Dt. 23/10/2026

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin nr.3 dt 06.01.2026 nr prot.05.

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Automjeti tip **Ford Wag me targë AB598LO harxhon 5 Litra/100 Km Gazoil D1**

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese,disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit ,tipi e lloji i mjetit,amortizimi i tij.

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cenolli

P. Kloudja

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 05/5 Prot Dt 13/01/2026

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296,datë 08.07.2010'Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin nr.3 dt 06.01.2026 nr prot.05.

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Automjeti tip **Ford Fiesta me targë AA171OE harxhon 5 Litra/100 Km Gazoil D1**

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese,disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit ,tipi e lloji i mjetit,amortizimi i tij.

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PERGJITHSHEM

Altin Cenolli

Pl

Kloudjo Toska

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE BASHKIA ELBASAN